


# Vlerësimi i nevojave për aftësi në sektorin e mobilerisë në Kosovë

Përgatiti: Edutask, Kosovë

Dhjetor 2022



Ky raport financohet nga: Projekti Nxitja e Mundësive të Punësimit dhe Rritjes (FEGO)  
Projekti Fego në Kosovë financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim  
Ndërkombëtar (SIDA) dhe zbatohet nga Swisscontact në Kosovë.

## **Tabela e Përmbajtjes**

<b><i>Përmbledhja ekzekutive</i></b> .....	<b>5</b>
<b><i>Hyrje</i></b> .....	<b>8</b>
<b><i>Metodologjia</i></b> .....	<b>10</b>
<b>Instrumentet për mbledhjen e të dhënave</b> .....	<b>10</b>
Pyetësoni .....	10
Intervistat .....	11
<b>Përzgjedhja e mostrës</b> .....	<b>11</b>
<b><i>Përshkrimi i mostrës</i></b> .....	<b>13</b>
<b><i>Gjetjet</i></b> .....	<b>18</b>
<b>Trajnimi dhe arsimi</b> .....	<b>18</b>
<b>Prodhimi</b> .....	<b>21</b>
<b>Aftësitë profesionale</b> .....	<b>23</b>
Si përballen kompanitë me nevojat për aftësi .....	29
<b>Kushtet e punës</b> .....	<b>35</b>
<b>Faktorët që ndikojnë në detyrat</b> .....	<b>36</b>
<b>Intervistat</b> .....	<b>39</b>
<b><i>Përfundime</i></b> .....	<b>43</b>
<b><i>Referencat</i></b> .....	<b>46</b>
<b>Shtojca 1: Lista e të intervistuarve</b> .....	<b>14</b>
<b>Shtojca 2: Protokoli i anketës ballë për ballë</b> .....	<b>15</b>
<b>Shtojca 3: Protokoli i intervistimit</b> .....	<b>51</b>

## Lista e figurave

Grafiku 1. Numri i përgjigjeve sipas rolit të të anketuarve.....	13
Grafiku 2. Ndërkombëtarizimi i kompanive.....	14
Grafiku 3. Eksporti dhe certifikimi.....	15
Grafiku 4. Kompanitë që testojnë produktet e tyre.....	16
Grafiku 5. Kompanitë që marrin pjesë në shoqata.....	16
Grafiku 6. Anëtarësimi në shoqata.....	17
Grafiku 7. Rishikimi i rregullt i aftësive dhe nevojave për trajnim për punonjësit .....	18
Grafiku 8. Trajnimi i zhvilluar në dy vitet e fundit.....	19
Grafiku 9. Numri i kompanive sipas llojeve të trajnimeve të mbajtura nga kompanitë .....	19
Grafiku 10. Njohuri për kurrikulat e universiteteve.....	20
Grafiku 11. Njohuri për opsionet e trajnimit të jashtëm dhe shpërndarjen e kompanive .....	20
Grafiku 12. Problemet e kompanive në plotësimin e vendeve të lira të punës për shkak të mungesës së aftësive adekuate të aplikantëve .....	21
Grafiku 13. Arsimi i kërkuar në pozitat e prodhimit .....	21
Grafiku 14. Numri i kompanive* sipas llojeve të trajnimeve të mbajtura nga kompanitë .....	22
Grafiku 15. Shpërndarja e aftësive sipas nivelit aktual dhe të ardhshëm .....	28
Grafiku 16. Frekuenca e aftësive të tjera të nevojshme në të ardhmen .....	28
Grafiku 17. Strategjitë për trajtimin e zhvillimit të aftësive .....	29
Grafiku 18. Vështirësi në gjetjen e klasave ose trajnerëve për të zhvilluar aftësitë e personelit .....	29
Grafiku 19. Vështirësi në rekrutimin e stafit të ri që i përshtatet kërkesave.....	30
Grafiku 20. Interesimi për të investuar në programet e zhvillimit të aftësive .....	30
Grafiku 21. Niveli i rëndësisë dhe aftësisë nga këndvështrimi i kompanive.....	31
Grafiku 22. Numri i punonjësve që do të trajnohen në tre vitet e ardhshme për secilën nga aftësitë.....	32
Grafiku 23. Pozicione që janë të vështira për t'u plotësuar.....	34
Grafiku 24. Kushtet e punës.....	35
Grafiku 25. Ndryshimet në praktika për shkak të inovacioneve.....	36
Grafiku 26. Ndryshimet në praktikat me ndikim në punën e punonjësve .....	36
Grafiku 27. Faktorët që çojnë në ndryshime.....	37
Grafiku 28. Shërbimet e jashtme .....	38
Grafiku 29. Themelimi i qendrës mbështetëse për kompanitë e përpunimit të drurit në Ferizaj? .....	38



## Lista e tabelave

Tabela 1. Numri i kompanive, intervistave dhe punonjësve të mostrës .....	12
Tabela 2. Aftësitë e nevojshme për t'u mësuar në punë ose shkollë .....	23
Tabela 3. Kërkesat për aftësi sipas pozicioneve .....	24
Tabela 4. Niveli i rëndësisë për aftësitë aktuale dhe të ardhshme .....	26
Tabela 5. Numri i punonjësve që do të trajnohen në tre vitet e ardhshme në nivel rajonal për secilën nga aftësitë .....	33
Tabela 6. Funkcionet që ndikohen nga ndryshimet në punë dhe kërkesat për aftësi .....	37

## Shkurtesat

ARBK	Regjistri Kombëtar i Bizneseve në Kosovë
ESNAF	Shoqata e Biznesmenëve
SHPDF	Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Ferizajt
SHPDK	Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës
USHAF	Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Ferizajt

## Përmbledhja ekzekutive

Biznesi i mobilerisë së drurit në Kosovë është përhapur në vitet e fundit. Megjithatë, zhvillimi i industrisë ka nxjerrë në pah domosdoshmërinë për staf të kualifikuar. Megjithëse ka dakordim mes kompanive mbi nevojën për personel të kualifikuar, kërkesat për kompetenca dhe aftësi specifike për të adresuar sfidat e rritjes, modernizimit dhe eksportit duhet të artikuloohen më mirë. Ky studim vlerësues me metoda të përziera (mikse), që përfshin të dhëna nga anketa me 100 kompani dhe intervista me gjashtë palë të tjera të interesit, synon të kuptojë trendët ekzistuese dhe të ardhshëm në nevojat për aftësi në sektorin e mobilerisë së drurit në Kosovë dhe të identifikojë nevojat themelore të trajnimit afatshkurtër që do të informojnë ofruesit e trajnimit dhe kompanitë për të strukturuar zhvillimin e fuqisë punëtore në këtë sektor. Studimi përqendrohet në atë se sa punonjës me aftësi specifike nevojiten në baza vjetore dhe në cilat rajone, duke eksploruar objektivat e mëposhtme primare:

1. Identifikimi i profesioneve të ndryshme në sektorin e mobilerisë
2. Vlerësimi i nivelit të aftësive të punonjësve të ndryshëm në sektorin e mobilerisë
3. Eksplorimi i trendëve të rritjes dhe ndryshimeve teknologjike në sektor
4. Parashikimi i nevojave dhe aftësive të punonjësve për një periudhë pesëvjeçare
5. Identifikimi i ofruesit të trajnimit dhe programeve të trajnimit të ofruara për punonjësit në këtë sektor

Së pari, ky studim analizon aspektet e trajnimit dhe edukimit të kompanive në industrinë e mobilerisë. Shqyrton se si kompanitë i rishikojnë nevojat e stafit të tyre për trajnim, nëse ata kryejnë trajnime të brendshme apo të jashtme, llojet e trajnimeve të ofruara dhe njohuritë rreth programeve të universiteteve ose ofertave për trajnim në kompani të jashtme. Më pas, ai përfshin perspektivat e ndryshme sesi kompanitë trajtojnë punonjësit në proceset e prodhimit. Analizon nëse ka probleme në plotësimin e vendeve të lira në prodhim, cilat janë kërkesat e nivelit arsimor për këto pozita dhe sa zgjat trajnimi në punë.

Ai vazhdon me një analizë të thellë të vlerësimit të aftësive për punonjësit në sektorin e prodhimit. Fillimisht, rishikon se ku duhet të fitohen aftësitë në shkollë ose në punë, duke ofruar një perspektivë esencial të asaj që kompanitë presin nga punonjësit në sektorin e prodhimit të kenë mësuar si aftësi në shkollë dhe çfarë mund të ofrojnë më vonë si trajnim brenda ose jashtë vendit të punës. Më pas eksploron aftësitë e nevojshme në nivele të ndryshme organizative dhe fokusohet në nivelin aktual të aftësive dhe atë të ardhshëm që nevojitet për

secilën prej tyre si dhe strategjitë për trajtimin e zhvillimit të aftësive. Në fund, ai analizon se si kompanitë merren me nevojat për aftësi nga perspektiva e trajnimit.

Për fund, ai fokusohet në kushtet e punës që gjenden zakonisht në vendet e punës dhe çfarë inovacioni kanë futur kompanitë kohëve të fundit dhe si kanë ndikuar ato në detyrat e punonjësve.

Disa nga gjetjet kryesore përfshijnë analizën e aftësive të nevojshme për të ardhmen. Është konstatuar se përzgjedhja e thikave, sharrave, teheve, kokave prerëse ose rripave sipas procesit të punës, funksioneve të makinës dhe specifikimeve të produktit, së bashku me ngecjen dhe rregullimin e teheve, kokave prerëse, rripave lëmues, përdorimit të veglave dhe ndjekjes së rregullave, presimit, tornimit (formësimit), lëmimit dhe lustrimit janë të rëndësishme për të ardhmen. Këto aftësi korrespondojnë me rritjen e përdorimit të makinerive CNC ose metodave të përmirësuara të prodhimit, ku varësisht nga madhësia e kompanisë, roli i operatorit të CNC dhe makinistit të CNC mund të jetë i ndarë ose i kombinuar, prandaj megjithëse ofrohen trajnime të konsiderueshme, veçanërisht për rolin e operatorit të CNC, studimi konkludon nevoja të mëtejshme për trajnim dhe identifikon nevojën për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive që lidhen me rolin e makinistit CNC në të ardhmen. Teknikët e makinerive ishin pozitat më të vështira që të gjenden, pasuar nga instaluesit dhe teknikët për sharrim.

Disa aftësi të tjera të vëna në pah gjatë studimit janë përdorimi i softuerit *Cad*, aftësive analitike, aftësive të dizajnit dhe programimit për CNC. Aftësi të tjera, si sharrimi, shpimi, ngjitja, leximi i specifikimeve ose ndjekja e udhëzimeve, janë aftësi shumë të vlerësuara për momentin por nuk do kërkohen në numër më të madh në të ardhmen. Nga ana tjetër, instalimi, planifikimi dhe riparimi, që konsiderohen në një nivel aktual të mirë, kanë më pak gjasa të kërkohen në numër të madh në të ardhmen. Përveç kësaj, studimi zbulon se aftësitë e përgjithshme të llogaritjes, punës në ekip dhe të aftësive të shkruarit janë më të zotëruarat nga punonjësit. Në të njëjtën kohë, gjuhët e huaja, njohuritë kompjuterike, planifikimi i burimeve, inovacioni/kreativiteti dhe aftësi të tjera të përgjithshme duhet të përmirësohen.

Gjithashtu, është konstatuar se ka kërkesë më të madhe për trajnim në tre vitet e ardhshme për njohuri të gjuhëve të huaja, kompjuterit, mbrojtjes së mjedisit, aftësive manuale dhe teknike. Rajonet të cilat do të kërkojnë më shumë trajnime janë Prishtina, Prizreni dhe Ferizaj. Niveli më i ulët i kërkesës do të vijë nga Vitia, Suhareka, Deçani dhe Gjakova.

Ndryshimet më të rëndësishme të raportuara nga kompanitë janë ndryshimet në produkte ose shërbime, të ndjekura nga ndryshimet në organizimin e punës, metodat e shitjes ose marketingu dhe proceset e punës të ndikuar kryesisht nga preferencat e konsumatorëve, teknologjia dhe digjitalizimi.





## Hyrje

Prodhimi është një nga sektorët më të mëdhenj dhe me zhvillimin më të shpejtë të ekonomisë globale. Aktualisht përfaqëson 17% të BPV-së globale (Banka Botërore, 2021). Megjithatë pandemia COVID-19 zvogëloi në mënyrë drastike prodhimin, ashpërsia e krizës nuk pati të njëjtat efekte negative në industri siç ishte vlerësuar më parë (UNIDO, 2022). Një nga komponentët thelbësorë të industrisë së prodhimit është sektori i drurit. Industritë e drurit mbulojnë një gamë të gjerë aktivitetesh industriale, duke përfshirë biznesin e printimit, sektorët e prodhimit dhe konvertimit të pulpës dhe letrës, sektorët e përpunimit të drurit dhe sektorët e mobilerisë. Në vitin 2018, rreth 397.000 biznese ishin të angazhuara në industrinë e drurit në BE, duke përfaqësuar 19.6% të të gjitha kompanive prodhuese (EUROSTAT, 2021). Industritë e drurit kontribuuan me 139 miliard € në shumë të shtuar bruto në vitin 2018 dhe kanë mbështetur 3.1 milion vende të punës, duke përbërë 10.3 % të punësimit në të gjithë sektorët e prodhimit (EUROSTAT, 2021).

Një pjesë thelbësore e zhvillimeve në biznesin e prodhimit me bazë drurin është nevoja në rritje për personel të kualifikuar. Një studim në kuadër të projektit Erasmus+ CBHE MAKING 4.0 sugjeron se ka një deficit në njohuri, aftësi dhe kompetenca të Teknologjive Kyçe Mundësuese në mesin e punonjësve të BE-së në sektorët e drurit, mobilerisë dhe prodhimit, si dhe në mesin e studentëve në arsimin e lartë (Romero Gázquez et al., 2021). Ri-formësimi dhe ngritja e aftësive të fuqisë punëtore është e nevojshme për një tranzicion të qëndrueshëm në zinxhirë të rinj vlerash me bazë bio (Komisioni Evropian, 2022). Punëtorët duhet të kenë një nivel të lartë të aftësive të shumëfishta për të pasur sukses në industrinë e prodhimit të drurit të bazuar në njohuri.

Zhvillimi i ekspertizës së punës në prodhimin e drurit është një shqetësim i konsiderueshëm për ekonominë e Ballkanit Perëndimor, e veçanërisht për Kosovën. Industria e drurit në Kosovë është një nga sektorët më fitimprurës të prodhimit dhe mendohet të ketë një nga potencialet më të larta për rritje në të ardhmen, gjenerimin e vendeve të punës dhe eksportit (Rizvanolli, 2017; Strategy & Development Consulting, 2016). Sektori i prodhimit të drurit në Kosovë ka 1,429 punëtorë në 408 kompani dhe një qarkullim vjetor prej 44.50 milionë eurosh (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës, 2020). Në vitin 2019, punësimi është rritur për 2.77%, dhe qarkullimi është rritur për 17.36% (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës, 2020). Gjithashtu, në nën-sektorin e prodhimit të drurit, eksportet janë rritur me 41,94% në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, ndërsa importet janë rritur me 9.07% gjatë të njëjtit vit (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës, 2020). Një studim i kryer nga Wiegel dhe Nixha (2018) në

sektorin e mobilerisë nga druri në Kosovë identifikoi pesë barriera të brendshme të eksportit: mungesën e stafit me njohuri dhe përvojë në eksport; vështirësinë në gjetjen e klientëve dhe distributorëve jashtë vendit; mungesën e teknologjisë moderne; mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar; mungesën e financave për inovacionin dhe pesë barriera të jashtme të eksportit: vështirësitë e personelit që të udhëtojnë në vendet e BE-së; mungesën e fuqisë punëtore me aftësi specifike për sektorin; perceptimi i produkteve "Prodhuar në Kosovë (Made in Kosova)"; kërkesat e certifikimit/standardet e cilësisë; dhe vështirësitë në sigurimin e financimit për eksport.

Kompanitë në industrinë e prodhimit të drurit e konsiderojnë mungesën e punëtorëve të trajnuar si një nga sfidat kryesore për zhvillimin e sektorit, gjersa rriten kërkesat për përdorimin e teknologjive të reja dhe për produkte të cilësisë më të lartë në tregjet e brendshme dhe ndërkombëtare. Disa studime (Rizvanolli, 2017; Wiegel & Nixha 2018) tregojnë se nevojat e fuqisë punëtore në sektorin të prodhimit të drurit nuk janë duke u plotësuar nga cilësia e sistemit arsimor dhe trajnimit të ofruar në Kosovë. Këto studime theksojnë nevojën për të promovuar arsimin profesional, duke pajisur në mënyrë efektive shkollat e APP-së, QAP-të dhe objektet e arsimit të lartë, si dhe trajnimin e instruktorëve dhe trajnerëve.

Ky raport studion aftësitë e nevojshme për kompanitë e prodhimit të drurit. Së pari, ai jep informata mbi modelet në nivel të sektorit në menaxhimin e kompanisë dhe punësimit në profesione të ndryshme të prodhimit të drurit bazuar në të dhënat dytësore dhe një ankete të administruar për ndërmarrjet në industri. Së dyti, ai analizon kompetencat specifike të profesionit për një profesion që konsiderohet shumë i rëndësishëm për realizimin e potencialit të sektorit.

## Metodologjia

Hulumtimi përdor metodën e përzier (mikse) me mbledhjen e njëpasnjëshme të të dhënave, analizën e anketave me punonjësit dhe intervistat me ekspertë të industrisë dhe menaxherët e prodhimit të kompanive. Analiza dytësore e të dhënave fokusohet në identifikimin e trendëve rajonale dhe globale në nevojat për aftësi dhe ofrimin e trajnimeve që përcaktojnë shtegun për rritje të sektorit të drurit në Kosovë (p.sh. produktet/shërbimet sipas trendit, inputet, metodat e prodhimit, përvojat, etj.). Hulumtimi parësor konsiston në një anketë të hartuar dhe shpërndarë në 100 kompani që janë aktive në sektorin e drurit duke përdorur metodën e thjeshtë të rastësishme [ang. *random*] nga baza e të dhënave të ARBK-së, duke mbuluar të gjitha rajonet e Kosovës. Gjithashtu, është zhvilluar një analizë cilësore me intervista me ekspertë të industrisë, ofrues trajnimesh dhe drejtorë të prodhimit dhe menaxhimit në kompanitë më të mëdha të sektorit.

### Instrumentet për mbledhjen e të dhënave

Janë përdorur dy instrumente për mbledhjen e të dhënave mbi inventarin e aftësive për sektorin, si dhe për hulumtimin e çështjeve që lidhen me trajnimin.

I pari është një pyetësor që kuantifikon perspektivat mbi këto çështjet nga pozitat e ndryshme organizative. E dyta - intervista, synon të thellojë këto gjetje dhe të kuptojë më mirë fenomenet, jo vetëm nga këndvështrimi i brendshëm i kompanisë, por edhe nga ofruesit e shërbimeve (kompanitë e trajnimit) si dhe shoqatat e industrisë, të cilat kanë një pamje më të gjerë të nivelit të aftësive në Kosovë.

### Pyetësi

Duke pasur parasysh gamën e gjerë të të anketuarve dhe përfitimet e mbledhjes së informacionit nga menaxherët e prodhimit, pronarët, drejtorët menaxhues, mbikëqyrësit dhe pozitat e tjera, është zhvilluar një pyetësor për dy nivele punonjësish: 1) pronarët, menaxherët dhe burimet njerëzore dhe 2) punonjësit në prodhim. Duke marrë parasysh që jo të gjithë të anketuarit kishin informata mbi të dhënat e përgjithshme të kompanisë, disa nga pyetjet për personelin e nivelit 2 (si mbikëqyrësit e dyshemesë dhe menaxherët e linjës/produktit) janë filtruar.

Si rezultat, menaxhmentit të kompanisë iu parashtruan 54 pyetje në modulet e mëposhtme (shih **Error! Reference source not found.**):

- Moduli 1 përmbante 19 pyetje rreth firmës dhe sektorëve primar dhe dytësorë ku ajo operon. Kjo pasohet nga pyetjet për të anketuarit që janë pronarë, drejtorë ekzekutivë ose menaxherë të burimeve njerëzore. Pyetjet e adresuara vazhduan me të dhëna të tjera për kompaninë, eksportet, punësimin sipas gjinisë, moshës, numrit të përgjithshëm të punonjësve, veçanërisht prodhimit, stafit drejtues, stafit administrativ, si dhe vështirësive në plotësimin e vendeve të lira.
- Moduli 2 ndërlidhet me trajnimin dhe edukimin dhe ka pyetje për të shqyrtuar nevojat për aftësi, trajnimin e ofruar dhe njohuritë e punonjësve (7 pyetje).
- Moduli 3 përfshin pyetje që u referohen vetëm punonjësve që merren me prodhimin, numrin, moshën, gjininë, përkatësinë etnike dhe moshën. Të anketuarit janë pyetur në lidhje me vendet e lira të punës dhe vështirësinë e plotësimit të tyre me punonjës me aftësitë e duhura, nivelin e arsimit të kërkuar për punonjësit, nevojën për trajnim dhe kohëzgjatjen e trajnimit që kanë kryer (8 pyetje).
- Moduli 4 mbulon aftësitë e nevojshme profesionale dhe të kërkuara nga punonjësit (9 pyetje).
- Dhe së fundi, Moduli 5 mbuloi kushtet e punës dhe nxitësit e ndryshimit të detyrës (inovacioni në biznes) (11 pyetje)

### Intervistat

Gjashtë intervista me profilet e mëposhtme:

- Dy drejtues të kompanive më të mëdha në sektor
- Dy ekspertë të industrisë nga Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPDK)
- Dy ofrues të licencuar të trajnimit

Intervistat ishin gjysmë të strukturuar dhe u kryen pas rezultateve të anketës (shih **Error! Reference source not found.**).

### Përzgjedhja e mostrës

Janë identifikuar disa kompani duke përdorur një përzgjedhje të rastësishme të mostrës së shtresuar bazuar në kodin NACE të aktivitetit ekonomik (12.11.2020) për kodin e tyre parësor dhe dytësor 3101, 3102, 3109, 1610 dhe 1623 në bazën e të dhënave të ARBK-së. Prioritet i është dhënë aktivitetit parësor, megjithëse edhe aktivitetet dytësore për kodet NACE 1621, 1624 dhe 1629 janë kontrolluar dhe përfshirë. Kompanitë janë ndanë sipas rajoneve dhe u janë caktuar anketuesve. Kontakti i parë është bërë me telefon me secilin prej tyre. Shumica e

kompanive ishin bashkëpunuese dhe shkëmbyen kontaktet. Nëse një kompani refuzonte të marr pjesë, kontaktohej kompania pasuese në listë.

Intervistuesi i dërguar në kompaninë e caktuar realizoi intervistën ballë për ballë për të mbledhur përgjigjet duke përdorur pyetësoin. Si rezultat, janë mbushur gjithsej 274 pyetësorë me pronarë, drejtorë ekzekutivë, menaxherë të burimeve njerëzore, menaxherë të linjës/prodhimit, mbikëqyrës ose pozita të tjera menaxhues në 100 kompani (shih Tabela1), me një mesatare prej pothuajse tre përgjigjesh për secilën kompani.


*Tabela1. Numri i kompanive, intervistave dhe punonjësve të mostrës*

	Numri i kompanive	Numri i punonjësve	Numri mesatar i punonjësve	Numri i intervistave
<b>Deçan</b>	3	23	8	9
<b>Ferizaj</b>	15	105	8	43
<b>Fushë Kosovë</b>	9	60	8	16
<b>Gjakovë</b>	6	58	10	18
<b>Gjilani</b>	11	129	12	32
<b>Mitrovicë</b>	11	200	15	36
<b>Pejë</b>	19	342	19	56
<b>Podujevë</b>	3	26	9	6
<b>Prishtinë</b>	7	66	11	14
<b>Prizreni</b>	13	123	12	32
<b>Suharekë</b>	2	9	5	6
<b>Viti</b>	2	10	5	6
<b>Totali i përgjithshëm</b>	<b>100</b>	<b>1 151</b>	<b>12</b>	<b>274</b>

Kompanitë e mostrës kanë gjithsej 1.151 punonjës, me një mesatare prej 12 personash që punojnë në të njëjtën organizatë.

## Përshkrimi i mostrës

Janë marr gjithsej 274 përgjigje nga persona të ndryshëm në organizatë. Shumica e përgjigjeve vijnë nga Menaxheri i Prodhimit, të ndjekura nga Pronari. Ne kemi prioritzuar të parin në rastet kur i njëjti person ka pasur dy role të ndryshme.



Grafiku1. Numri i përgjigjeve sipas rolit të të anketuarve

Kompanitë e përfshira në studim janë kryesisht të vogla<sup>1</sup>. Kompanitë mikro dhe të vogla përbëjnë shumicën e mostrës (54 dhe 45 raste), ndërsa vetëm një kompani është e mesme me 60 punonjës.

Norma mesatare e prodhimit për të punësuarit total është rreth 76%. Duke marrë parasysh një numër mesatar prej 12 punonjësish, pothuajse tre kanë funksione administrative ose menaxheriale.

Është interesante se 18 kompani kanë të paktën një grua që punon në proceset e prodhimit. Rasti më i veçantë është rasti i një kompanie me 40 punonjës, nga të cilët 18 janë gra. Megjithatë, në përgjithësi, shkalla e pranisë së grave është e ulët (pothuajse 4%).

Konsideratat e njëjta mund të bëhen për punonjësit nga komunitetet jo-shumicë që punojnë në prodhim. Janë raportuar gjithsej 57 punonjës nga komunitetet jo-shumicë, që përbëjnë pothuajse 5% të totalit të punonjësve të mostrës.

Numri i punonjësve të huaj të në kompanitë e anketuara është i ulët. Vetëm dy kompani kanë deklaruar se kanë punësuar gjithsej katër punonjës të huaj.


<sup>1</sup>Komisioni Evropian përkufizon ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NVM) në Rekomandimin e BE-së 2003/361. <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2003:124:0036:0041:en:PDF> nëse janë të punësuar më pak se 250 persona; NVM-të ndahen më tej në mikro-ndërmarrje: më pak se dhjetë persona të punësuar; ndërmarrjet e vogla: 10 deri në 49 persona të punësuar; ndërmarrjet e mesme: 50 deri në 249 persona të punësuar; Ndërmarrjet e mëdha përcaktohen nëse janë të punësuar 250 ose më shumë persona.

Kur shohim moshën e punonjësve, ata janë midis 30 dhe 50 vjeç. Këto shifra plotësohen nga gjeneratat e reja (më pak se 33%), ndërsa punonjësit mbi 50 vjeç përfaqësojnë vetëm 9%.

	< 30	30-50	>50
Numri i punonjësve	379 (pothuajse 33%)	670 (pothuajse 58%)	102 (pothuajse 9%)

### *Eksporti dhe Certifikimi*

Shumica e kompanive eksportojnë në tregjet evropiane dhe rajonale duke pasur gjithmonë prezencë në tregun vendas. Vetëm 24 kompani nuk shesin në tregun lokal, por në tregun evropian ose rajonal (shih Grafiku2).




*Grafiku2. Ndërkombëtarizimi i kompanive*

Pavarësisht efektit të madhësisë, 31 raste raportojnë se kanë certifikim për produktet e tyre (Grafiku3). Ndërsa 12 kompani thonë se nuk kanë nevojë për certifikim, 19 të tjerat duhet të respektojnë rregullat e eksportit dhe të certifikojnë origjinën e drurit dhe standardet ISO.

Ata pohojnë se certifikimi është i nevojshëm për sa vijon:

- Analiza e drurit
- Certifikimi fitosanitar
- Certifikimi i biznesit
- ISO9001
- R1-Euro1




Grafiku3. Eksporti dhe certifikimi

### *Testimi i produkteve*

Shumica e kompanive i testojnë produktet e tyre (55 kompani) (shih Grafiku4). Zakonisht, testimi përfshin kontrollin vizual ose teste të ndryshme për cilësinë e mekanizmave dhe çështje të tjera teknike. Në disa raste bëhen edhe analiza fizike dhe materiale. Më poshtë është dhënë një listë e plotë e testeve më të zakonshme:

- Testimi para montimit
- Testimi i cilësisë së sfungjerit, llojet e drurit
- Testet e qëndrueshmërisë
- Testimi i mekanizmit
- Stabiliteti i produktit
- Forca, cilësia e produkteve
- Testet fizike dhe teknike
- Testimi i forcës së drurit dhe përmbajtjes e lagështisë së tij.
- Inspektimi vizual, kontrolli paraprak i materialit, përcaktimi i stabilitetit
- Dyer, kuzhinë, lagështi, teste ngjyrash.
- Verifikimi i defektit
- Testet e dyerve të mobilerisë të kuzhinës
- Testi i lagështisë
- Testimi i cilësisë dhe qëndrueshmërisë






Grafiku4. Kompanitë që testojnë produktet e tyre


### Anëtarësimi në shoqata

Vetëm 18 kompani janë anëtarë të shoqatave të ndryshme (shih Grafiku5). Tre prej tyre janë anëtarë në më shumë se një shoqatë.



Grafiku5. Kompanitë që marrin pjesë në shoqata

Shoqatat kryesore janë Shoqata Kosovare e Prodhimit të Drurit "SHDPK" (9 kompani), Oda Ekonomike e Kosovës (4 kompani), Shoqata e Biznesmenëve "EsnaF" (3 kompani) dhe Oda Kombëtare e Zejtarëve (2 kompani); (Shiko Grafiku 6).



Grafiku 6. Anëtarësimi në shoqata

## Gjetjet


Të dhënat e mbledhura analizohen dhe paraqiten në pesë fusha kryesore:

1. Trajnimi dhe Edukimi
2. Prodhimi
3. Aftësitë
4. Kushtet e punës
5. Faktorët që ndikojnë në detyrat

### Trajnimi dhe arsimi


Ky seksion përfshin një përmbledhje të trajnimit dhe arsimit të kërkuar nga kompanitë që punojnë në industrinë e mobilerisë. Ai analizon se si kompanitë rishikojnë nevojat e tyre për trajnim të stafit, nëse bëjnë trajnime të brendshme apo të jashtme, llojet e trajnimeve të ofruara dhe njohuritë në lidhje me programet e universiteteve apo ofertat për trajnime të jashtme.

Të anketuarit u pyetën nëse kompanitë e tyre rishikonin rregullisht aftësitë dhe nevojat për trajnim të punonjësve të tyre. Ndërsa pothuajse 27% e tyre nuk e bënin këtë, pjesa tjetër bëjnë analiza të rregullta të aftësive dhe nevojave të tyre për trajnim për disa nga punonjësit (35%) ose për të gjithë ata (38%) (shih Grafiku7).




Grafiku7. Rishikimi i rregullt i aftësive dhe nevojave për trajnim për punonjësit

Gjithashtu, ata u pyetën nëse janë duke ofruar trajnime të brendshme apo të jashtme për punonjësit e tyre. Vetëm 31% e kompanive kanë mbajtur të paktën një trajnim në dy vitet e fundit (shih Grafiku 8).



Grafiku 8. Trajnimi i zhvilluar në dy vitet e fundit

Llojet e trajnimeve të mbajtura nga kompanitë me të paktën një trajnim në dy vitet e fundit janë paraqitur në Grafiku9. Trajnimi jashtë punës përbën 10% të rasteve; vetëm pesë kompani deklarojnë se kanë mbajtur trajnime nga kompani të jashtme. Lloji më thelbësor i trajnimit bëhet në kompani. Pothuajse 50% e trajnimeve janë internshipe të organizuara nga kompanitë. Pjesa tjetër janë trajnime në punë që u ofrohen punonjësve (33%), ndërsa vetëm 5% e trajnimeve organizohen nga ofrues të palëve të treta dhe 4.8% janë deklaruar si modalitete të tjera trajnimi.




Grafiku9. Numri i kompanive sipas llojeve të trajnimeve të mbajtura nga kompanitë

\*Shënim: Numri i kompanive është kumulativ për llojet e trajnimeve të mbajtura nga e njëjta kompani.


Sa i përket universiteteve, vetëm 20 kompani kanë njohuri për kurrikulat që ata i ofrojnë (Grafiku10). Më të njohurit janë Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Ferizajt dhe deri diku Universiteti i Prishtinës.

Kjo është e ngjashme me numrin e kompanive që njohin trajnimin e ofruar nga kompani të jashtme. Vetëm në 19 raste kompanitë deklarojnë se kanë njohuri të tilla. Kompanitë më të cituara janë Shehu Academy (5 kompani) dhe Dekoriti (4 kompani), të ndjekura nga ABC

Design (1 kompani) dhe disa raste të kompanive ndërkombëtare që trajnojnë kompanitë për teknologjitë e tyre (1 kompani) dhe SHPDK (1 kompani).



Grafiku10. Njohuri për kurrikulat e universiteteve




Grafiku11. Njohuri për opsionet e trajnimit të jashtëm dhe shpërndarjen e kompanive

## Prodhimi


Ky seksion përfshin perspektivat e ndryshme se si kompanitë sillen me punonjësit në proceset e prodhimit. Ai analizon nëse ka probleme në plotësimin e vendeve të lira në prodhim, cilat janë kërkesat e nivelit arsimor për këto pozicione dhe sa zgjat trajnimi në punë.

Të anketuarit u pyetën për vendet e lira të punës në fushën e prodhimit që është e vështirë të plotësohen për shkak të mungesës së aftësive adekuate të aplikantëve (Grafiku12). Shumica e kompanive pretendojnë se kanë probleme (63%) në lidhje me aftësitë e aplikantit.



Grafiku12. Problemet e kompanive në plotësimin e vendeve të lira të punës për shkak të mungesës së aftësive adekuate të aplikantëve


Niveli i nevojshëm i arsimimit të punonjësve në prodhim është zakonisht i ulët (Grafiku13). Në të vërtetë, shumica e kompanive zgjedhin punonjës me arsim të ulët si shkolla fillore (35%), shkolla e mesme (32%) ose shkolla profesionale (22%). Vetëm 8% e kompanive pretendojnë të përdorin trajnimin në punë për të arritur nivelin e arsimit të nevojshëm në prodhim. Universiteti është niveli arsimor më pak i kërkuar për prodhim (3% e kompanive).



Grafiku13. Arsimi i kërkuar në pozitat e prodhimit

Gjithashtu, kompanitë u pyetën se sa muaj zgjat trajnimi tipik në vendin e punës për punonjësit e rinj në prodhim. Shumica e tyre trajnohen brenda tre muajve (53%), ndërsa 44% e rasteve

zgjasin nga tre deri në dymbëdhjetë muaj. Shumë pak raste të trajnimit në punë zgjasin më shumë se një vit (3%).



Grafiku14. Numri i kompanive\* sipas llojeve të trajnimeve të mbajtura nga kompanitë

## Aftësitë profesionale

Ky seksion përfshin një analizë të plotë të vlerësimit të aftësive për punonjësit e prodhimit. Fillimisht, ai rishikon se ku duhet të fitohen aftësitë: në shkollë apo në punë. Kjo ofron një perspektivë thelbësore mbi atë që kompanitë presin nga punonjësit që punojnë në prodhim të kenë mësuar si aftësi në shkollë dhe çfarë ata mund të ofrojnë më vonë si trajnim brenda ose jashtë vendit të punës. Më pas ai eksploron aftësitë e nevojshme në nivele të ndryshme organizative dhe fokusohet në nivelin aktual të aftësive dhe nivelin e ardhshëm të nevojshëm për secilën prej tyre dhe strategjitë për trajtimin e zhvillimit të aftësive. Në fund, ai analizon se si kompanitë merren me nevojat për aftësi nga perspektiva e trajnimit.

Të anketuarve u janë bërë një grup pyetjesh mbi aftësitë që duhet fituar në punë ose në shkollë (shih Tabela 2). Dy aftësitë kryesore që kompanitë kërkojnë të mësohen në shkollë janë sharrimi dhe planifikimi. Formimi, instalimi, shpimi, presimi, tornimi, lëmimi, gdhendja, riparimi, lustrimi dhe ngjitja janë aftësi thelbësore që mund të mësohen në punë. Nga ana tjetër, leximi dhe interpretimi i specifikimeve ose ndjekja e udhëzimeve; instalimi dhe rregullimi i teheve, kokave prerëse, rripave për lëmim dhe përdorimi i veglave dhe respektimi i rregullave; përzgjedhja e thikave, sharrave, tehut, kokave ose rripave prerës sipas procesit të punës, funksioneve të makinerisë dhe specifikimeve të produktit; vendosja dhe rregullimi i llojeve të ndryshme të makinerive të përpunimit të drurit për përdorim nga të tjerët mbeten aftësi që mund të mësohen kryesisht në punë, por edhe faktori shkollë është i rëndësishëm.

Tabela 2. Aftësitë që duhet të mësohen në punë ose në shkollë

Shënim: ngjyra e kuqe tregon një frekuencë më të ulët; portokallia, një frekuencë mesatare-të ulët; e verdha, një frekuencë mesatare-e lartë dhe ngjyra jeshile, një frekuencë e lartë të dhënash.

	Në punë	Ne shkollë
Sharrimi	27	149
Formësimin	142	33
Instalimi	160	17
Shpimi	154	21
Planifikimi	68	111
Presimi	145	22
Tornimi (formësimi me torno)	145	19
Lëmimi	135	16
Gdhendja	156	14
Riparimi	150	20
Lustrim	142	20
Ngjitja	155	10



Leximi dhe interpretimi i specifikimeve ose ndjekja e udhëzimeve	112	53
Instalimi dhe rregullimi i teheve, kokave prerëse, rripave lëmues, përdorimi i veglave dhe ndjekja e rregullave	114	58
Përzgjedhja e thikave, sharrave, teheve, kokave prerëse ose rripave sipas procesit të punës, funksioneve të makinës dhe specifikimeve të produktit	124	63
Vendosja dhe rregullimi i llojeve të ndryshme të makinerive të përpunimit të drurit për operim nga të tjerët	114	52

Për më tepër, të anketuarve iu kërkua të deklaronin pozitat e punës ku këto aftësi nevojiteshin (shih Tabela 3). Konkretisht, shumica e aftësive kërkohen për pozicionin e *specialistit* (sharrim, formësim, instalim, presim, tornim, lëmim, gdhendje, riparim, lustrim), ndërsa për *menaxherët* nuk kërkohet që t'i ketë ato aftësi, me përjashtim të aftësisë së planifikimit që mes tjerash është aftësia më e kërkuar për këtë pozitë. Aftësitë më të rëndësishme të *operatorit* përfshijnë tre të mëparshmet: instalimin dhe rregullimin e teheve, kokave për prerje dhe rripave për lëmim si dhe përdorimin e mjeteve dhe respektimin e rregullave; përzgjedhjen e thikave, sharrave, teheve, kokave prerëse ose rripave sipas procesit të punës, funksioneve të makinës dhe specifikimeve të produktit; vendosja dhe rregullimi i makinerive të ndryshme për përpunimin e drurit që të operohen nga të tjerët. Mbikëqyrësi duhet të ketë të gjitha aftësitë, por është një pozitë që kërkon një nivel mesatar të të gjithave.

Tabela 3. Kërkesat për aftësi sipas pozitave

Shënim: ngjyra e kuqe tregon një shpeshësi më të ulët; portokallia, një shpeshësi mesatare-të ulët; e verdha, një shpeshësi mesatare-të lartë dhe ngjyra jeshile, një shpeshësi të lartë të të dhënave .

	Të gjitha pozitat	Menaxheri	Operatori	Specialist	Mbikëqyrësi
Sharrimi	45	9	42	70	15
Formësimin	46	9	43	62	20
Instalimi	51	12	34	60	24
Shpimi	50	7	46	40	38
Planifikimi	59	57	28	23	14
Presimi	46	9	48	52	22
Tornimi	47	5	42	58	22
Lëmimi	48	2	35	69	21
Gdhendje	47	7	35	58	29
Riparimi	57	3	28	58	33
Lustrim	48	6	48	48	26
Ngjitja	60	7	37	40	34

Leximi dhe interpretimi i specifikimeve ose ndjekja e udhëzimeve	84	10	41	30	16
Instalimi dhe rregullimi i teheve, kokave prerëse, rripave lëmues dhe përdorimi i veglave si dhe ndjekja e rregullave	51	3	69	33	24
Përzgjedhja e thikave, sharrave, teheve, kokave prerëse ose rripave sipas procesit të punës, funksioneve të makinës dhe specifikimeve të produktit	49	5	80	25	20
Vendosja dhe rregullimi i llojeve të ndryshme të makinerive të përpunimit të drurit për operim nga të tjerët	54	3	70	27	26

Sipas nivelit aktual të aftësive, të anketuarit theksojnë se aftësitë më aktuale më të rëndësishme janë realizimi i instalimeve të mira, shpimi, leximi i udhëzimeve dhe zgjedhja e funksioneve të duhura të makinës për të ndjekur specifikimet e produkteve. Pyetjet u parashtruan me një shkallë që varion nga 1 (nuk përdoret) deri në 5 (përdoret shumë shpesh).

Nga ana tjetër, disa aftësi të tjera mund të jenë më të rëndësishme në të ardhmen si lëmimi, presimi, tornimi dhe lustrimi, së bashku me aftësinë për instalimin dhe rregullimin e teheve, përdorimin e veglave dhe ndjekjen e rregullave si dhe përzgjedhjen e thika, sharrave, teheve, kokave ose rripave prerës sipas procesit të punës, funksioneve të makinerisë dhe specifikimeve

të produktit. Shkalla u transformua duke filluar nga 0 (pa përdorim të aftësisë në të ardhmen) në 5 (përdorim të plotë në të ardhmen).

Tabela4 tregon përgjigjet mesatare si për aftësitë aktuale dhe të ardhshme. Një elaborim i mëtejshëm është paraqitur në

Grafiku 15 Shpërndarja e aftësive sipas nivelit aktual dhe të ardhshëm. Ai tregon vendosjen e të gjitha aftësive sipas niveleve aktuale dhe të ardhshme të renditjes së kompanive.

Tabela4. Niveli i rëndësisë për aftësitë aktuale dhe të ardhshme


Shënim: ngjyra e kuqe tregon një shpeshtësi më të ulët; portokallia, një shpeshtësi mesatare-të ulët; e verdha, një shpeshtësi mesatare-të lartë dhe ngjyra jeshile, një shpeshtësi të lartë të dhënave.

	Aktual	e ardhmja
Sharrimi	4,1	4,17
Formësimin	3,9	4,25
Instalimi	4,4	4,09
Shpimi	4,2	4,23
Planifikimi	4	4,11
Shtypja	3,5	4,37
Tornimi	3,3	4,34
Lëmimi	3,4	4,39
Gdhendje	3,7	4,25
Riparimi	3,9	4,11
Lustrim	3,5	4,38
Ngjitja	4	4,26
Leximi dhe interpretimi i specifikimeve ose ndjekja e udhëzimeve	4,1	4,22
Instalimi dhe rregullimi i teheve, kokave prerëse, rripave për lënim, përdorimi i veglave dhe ndjekja e rregullave	3,8	4,32
Përzgjedhja e thikave, sharrave, teheve, kokave ose rripave prerëse sipas procesit të punës, funksioneve të makinerisë dhe specifikimeve të produktit	4,1	4,32
Vendosja dhe rregullimi i llojeve të ndryshme të makinerive të përpunimit të drurit për operim nga të tjerët	3,7	4,28

